VENDIM
Nr. 201, datë 25.3.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKITË DURRËS DHE KAMZË

(Ndryshuar me VKM nr. 291, datë 11.5.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i" dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 058 293 376 (një miliard e pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 835 060 995 (tetëqind e tridhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 223 232 381 (dyqind e njëzet e tre milionë e dyqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, në masën 211 658 675 (dyqind e njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 167 012 199 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 44 646 476 (dyzet e katër milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 278 585 905 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe u transferohet bashkive Durrës dhe Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 178 585 905 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe